



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Botimi 4

**BULETINI**

**I**

**UDHËZIMEVE TEKNIKE NR. 4**

(Korrik – Dhjetor 2018)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

**TABELA PËRMBLEDHËSE**

<b>1.</b>	<b>HYRJE</b> .....	<b>3</b>
<b>2.</b>	<b>UDHËZIME TEKNIKE</b> .....	<b>4</b>
	<i>2.1. Udhëzues mbi trajtimin e OJF-ve për efekt të TVSH-së</i> .....	<i>4</i>
	<i>2.2. Sqaruese për Drejtoritë Rajonale Tatimore me qëllim verifikimin, vlerësimin dhe llogaritjen e tatimit në burim për ambientet e dhëna me qira për qëllim të ushtrimit të një aktiviteti tregtar</i> .....	<i>7</i>
<b>3.</b>	<b>RASTË SPECIFIKE TË TATIMPAGUESVE TË TRAJTUARA PËR PROBLEME TË HASURA NË PRAKTIKË</b> .....	<b>10</b>
	<b>3.1 Nga fusha e ligjit të Tatimit mbi të Ardhurat</b>	
	<i>3.1.1 Trajtimi nga pikëpamja fiskale i huapërdorjes në rastet e sendeve të luajtshme</i> .....	<i>10</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

## 1. HYRJE

Marrëdhëniet ndërmjet administratës tatimore dhe tatimpaguesve rregullohen nëpërmjet dispozitave të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore dalë në zbatim të tyre. Këto dispozita saktësojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tatimpaguesit në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të tij tregtar. Vlen të theksohet se, prioriteti i administratës tatimore është trajtimi i njëjtë dhe në mënyrë të barabartë i të gjithë tatimpaguesve dhe respektimi korrekt dhe i njëjtë i dispozitave ligjore nga ana e tyre.

Në zbatim të Nenit 10, pika 3 e ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në funksion të marrëdhënies së vazhdueshme administratë tatimore – tatimpagues, si dhe e udhëhequr nga parimet e administrimit tatimor të parashikuara në nenin 12 të këtij ligji, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, publikon Buletinin Nr.4, në të cilin janë përfshirë sqaruese/orientuese dhe trajtime për raste specifike të adresuara në administratën tatimore nga tatimpagues të ndryshëm që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Ky Buletin vjen si vazhdimësi e Buletineve të mëparshëm të publikuara në website-in e administratës tatimore, në të cilin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në zbatim të detyrave të saj funksionale dhe në trajtim të dhjetra shkresave dhe kërkesave të tatimpaguesve apo edhe të strukturave të saj të varësisë, ka përmbledhur raste specifike, të cilat mund të shërbejnë si referencë për tatimpagues të ndryshëm në trajtimin e një sërë problemesh që kanë të bëjnë me zbatimin e legjislacionit tatimor, me procedurat tatimore apo edhe me çështje dhe raste praktike.

Referuar sa më sipër, ky Buletin, është një përmbledhje e sqarimeve, opinioneve dhe udhëzimeve, që kanë unifikuar qasjen e administratës tatimore kundrejt tatimpaguesve dhe përfshin periudhën nga 1 Korrik 2018 deri në 31 Dhjetor 2018.

Ky Buletin në logjikën e buletineve të mëparshëm është i organizuar në 3 kapituj, të cilët respektivisht janë ndarë në kapitullin hyrës, në kapitullin II, në të cilin përfshihet një sqaruese/orientuese që u drejtohet Drejtorive Rajonale, me qëllim sqarimin e procedurave në lidhje me regjistrimin apo çregjistrimin nga përgjegjësia tatimore e TVSH-së për OJF-të dhe unifikimin e veprimeve dhe qëndrimeve për trajtimin e këtyre të fundit. Ky kapitull përmban edhe një sqaruese në nëndarjen e dytë për Drejtoritë Rajonale Tatimore me qëllim verifikimin, vlerësimin dhe llogaritjen e tatimit në burim për ambientet e dhëna me qira për qëllim të ushtrimit të një aktiviteti tregtar. Ndërsa Kapitulli III trajton nga pikëpamja fiskale huapërdorjen për sendet e luajtshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

## 2. UDHËZIME TEKNIKE

### 2.1. Udhëzues mbi trajtimin e OJF-ve për efekt të TVSH-së.

Lënda: Udhëzues mbi trajtimin e OJF-ve për efekt të TVSH-së.

Drejtuar: Drejtorisë Rajonale Tatimore

Me qëllim sqarimin e procedurave në lidhje me regjistrimin apo çregjistrimin nga përgjegjësia tatimore e TVSH-së për OJF-të dhe unifikimin e veprimeve dhe qëndrimeve për trajtimin e OJF-ve, të gjitha Drejtoritë Rajonale Tatimore duhet të kenë parasysh si vijon:

Në kuptim të nenit 3, të Ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nuk konsiderohet person i tatueshëm dhe nuk regjistrohet për përgjegjësinë tatimore të TVSH-së, çdo organizatë jofitimprurëse për pagesa të përfituara nga kuotizacionet, nëse kanë të tilla, ose fonde, grante, donacione të përfituara për qëllime të veprimtarisë jofitimprurëse të organizatës, në përputhje me ligjin për organizatat jofitimprurëse, përveç kur kjo organizatë përfiton pagesa si rezultat i veprimtarisë ekonomike. Gjithashtu, nuk regjistrohen për përgjegjësinë tatimore të TVSH-së, OJF-të, të cilat parashikojnë të realizojnë nga veprimtaria dytësore ekonomike, një qarkullim më të vogël se 2.000.000 lekë, sipas parashikimeve të nenit 117, të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Mbart detyrimin ligjor për t'u regjistruar me përgjegjësinë tatimore të TVSH-së, çdo OJF e cila përveç aktivitetit të saj kryesor, ushtron veprimtari ekonomike si veprimtari dytësore dhe realizon një qarkullim mbi 2 000 000 (dy milionë) lekë në një vit kalendarik, edhe nëse kryen veprimtari të përjashtuar sipas ligjit apo posedon një autorizim për përjashtimin nga pagesa e TVSH-së.

Në të gjitha rastet kur, OJF të ndryshme, i drejtohen Drejtorisë Rajonale Tatimore për çregjistrimin e përgjegjësisë tatimore të TVSH-së, për ndonjë nga shkakqet e mëposhtme:

- ✓ janë regjistruar gabim me këtë përgjegjësi tatimore;
- ✓ nuk ushtrojnë më veprimtari ekonomike;
- ✓ qarkullimi i realizuar nga veprimtaria dytësore ekonomike, për 12 periudha mujore të njëpasnjëshme nuk e kalon vlerën prej 2.000.000 lekësh dhe në vijim pretendohet se qarkullimi i realizuar nga kjo veprimtari do të jetë më i ulët se 2.000.000 lekë në vit,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

hapat që duhet të ndiqen do të jenë si vijon:

**A. Trajtimi i rasteve kur pretendohet se përgjegjësia tatimore e TVSH-së është ngarkuar gabim:**

DRT përkatëse, së cilës i është adresuar kërkesa përcakton inspektorin e kontrollit që ka nën administrim dosjen e tatimpaguesit, që do të merren me trajtimin e rastit. Inspektori përgjegjës do të kryejë veprimet si vijon:

- Kontrollon dhe verifikon ligjshmërinë e kërkesës dhe detyrimin ligjor të këtij tatimpaguesi për t'u regjistruar ose jo me TVSH;
- Verifikon arsyet përse nga administrata tatimore është regjistruar me këtë përgjegjësi tatimore në momentin e regjistrimit;
- Kontrollon e verifikon dokumentacionin e administruar lidhur me aktivitetet që OJF-ja ka kryer nga momenti i regjistrimit, për të cilat duhet të japë gjykimin sipas ligjit nëse ato përmbushin ose jo kushtet ligjore që tatimpaguesi të regjistrohej në TVSH;
- Kontrollon të gjithë deklaratimet dhe transaksionet e kryera nga tatimpaguesi, qëllimin e kryerjes së tyre, burimin e të ardhurave dhe qëllimin e kryerjes së shpenzimeve të lidhura me këto transaksione etj.
- Kontrollon dorëzimin e të gjitha deklaratave të pagesës së TVSH-së në sistemin informatik. Nëse këto deklarata janë dorëzuar për çdo periudhë me zero, tregon se tatimpaguesi nuk ka ushtruar aktivitet me TVSH, përjashtoj rastet kur nga verifikimi rezulton se OJF-ja ka kryer aktivitet që duhet t'i nënshtrohej TVSH-së dhe qëllimisht nuk i ka deklaruar si të tilla. Në këto raste, inspektori propozon kryerjen e një kontrolli në vend me qëllim vlerësimin e detyrimeve tatimore dhe penaltitetet përkatëse për aktivitetin e padeklaruar.
- Në përfundim të verifikimit, inspektori jep mendim nëse OJF-ja duhet të çregjistrohet ose jo nga TVSH-ja. Materiali referues miratohet nga eprorët sipas manualit të Kontrollit dhe me miratimin nga drejtori i DRT-së vendoset për t'u çregjistruar ose jo OJF-ja nga përgjegjësia tatimore e TVSH-së.
- E gjithë procedura si më sipër, nuk mund të zgjasë më tepër se 30 ditë kalendarike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

**B. Trajtimi i rasteve kur OJF kërkon çregjistrim nga TVSH-ja për shkak se nuk ushtron dhe nuk do të ushtrojë më veprimtari ekonomike.**

DRT përkatëse, së cilës i është adresuar kërkesa ngarkon inspektorin e kontrollit që ka nën administrim dosjen e tatimpaguesit, që të merren me trajtimin e rastit. Inspektori përgjegjës do të kryejë veprimet si vijon:

- Verifikon pagesat e TVSH-së për periudhën që OJF-ja i është nënshtruar kësaj përgjegjësie dhe verifikon aktivitetin aktual të deklaruar, për të konkluduar nëse OJF duhet ta ketë këtë përgjegjësi tatimore në vijim ose jo;
- Verifikon nga kontrolli i fundit, gjithë aktivitetin e OJF-së të deklaruar për efekt të TVSH-së, dhe saktëson nëse ka periudha me aktivitet të pakontrolluara ose jo. Nëse nga kontrolli i fundit i ushtruar, rezulton se OJF-ja nuk ka kryer më aktivitet ekonomik dhe ka deklaruar me zero, të gjitha deklaratat e TVSH-së, procedura që ndiqet në vijim për trajtimin e kërkesës është sipas pikës A) më sipër;
- Nëse rezulton se ka periudha tatimore përgjatë të cilave OJF-ja ka ushtruar aktivitet ekonomik dhe për këto periudha nuk është kontrolluar për efekt të TVSH-së, DRT përkatëse duhet të kontrollojë në vend OJF-në për të saktësuar detyrimet e saj lidhur me TVSH-në;
- Përgjatë kontrollit, DRT kontrollon e verifikon aktivitetin që kryen aktualisht OJF-ja nëpërmjet analizimit të transaksioneve të kryera, informacioneve nga palë të treat, etj. Qëllimi i kontrollit bëhet për të gjykuar dhe analizuar aktivitetin e kryer në të shkuarën dhe aktivitetin që OJF-ja kryen aktualisht. Nga ky kontroll dhe jo vetëm, duhet të vlerësohet nëse aktiviteti që ushtron aktualisht OJF-ja duhet t'i nënshtrohen ose jo përgjegjësisë tatimore të TVSH-së;
- Në përfundim të kontrollit, nëpërmjet aktit të kontrollit, jepet mendimi nëse duhet të çregjistrohet ose jo OJF-ja nga përgjegjësia tatimore e TVSH-së sipas kërkesës;
- Nëse sipas kontrollit të ushtruar, jepet konkluzioni se tatimpaguesi duhet të çregjistrohet nga TVSH -ja, tatimpaguesi duhet të paguajë të gjitha detyrimet tatimore të TVSH-së dhe vetëm kur detyrimet për këtë tatim të jenë zero si në debi edhe në kredi, me miratimin nga Drejtori i DRT-së jepet urdhri që kërkuesi të çregjistrohet nga kjo përgjegjësi.

Kur një OJF, bën kërkesë për çregjistrim nga përgjegjësia tatimore e TVSH-së dhe sipas të dhënave të deklaruara dhe të administruara nga DRT, rezulton se qarkullimi për vitin e fundit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

fiskal është nën kufirin 2.000.000 lekë, atëherë për çregjistrimin nga TVSH-ja të OJF-së, do të zbatohen rregullat dhe kushtet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015, të Ministrisë të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, si për gjithë tatimpaguesit e tjerë.

Theksojmë se, Drejtoritë Rajonale duhet të tregojnë kujdes dhe të mbajnë nën monitorim të vazhdueshëm çdo OJF të çregjistruar nga përgjegjësia tatimore e TVSH-së.

Për sa është trajtuar në këtë udhëzues, Drejtoritë Rajonale Tatimore të marrin masa për zbatimin praktik të tij.

2.2. Sqaruese për Drejtoritë Rajonale Tatimore me qëllim verifikimin, vlerësimin dhe llogaritjen e tatimit në burim për ambientet e dhëna me qira për qëllim të ushtrimit të një aktiviteti tregtar.

Lënda: Sqaruese për Drejtoritë Rajonale Tatimore me qëllim verifikimin, vlerësimin dhe llogaritjen e tatimit në burim për ambientet e dhëna me qira për qëllim të ushtrimit të një aktiviteti tregtar.

Drejtuar: Drejtorisë Rajonale Tatimore

Bazuar në Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar dhe VKM nr. 469, datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve del me këtë sqaruese me qëllim unifikimin e procedurave lidhur me përlllogaritjen e tatimit për të gjitha ambientet ku ushtrohet aktivitet tregtar bazuar mbi një marrëveshje/kontratë të lidhur rregullisht midis subjektit tatimpagues dhe entitetit posedues të ambientit.

Të gjitha Drejtoritë Rajonale Tatimore duhet të marrin masat për organizimin e punës për verifikimin e dokumentacionit të administruar nga çdo DRT në dosjen personale të tatimpaguesit, që vërteton marrëdhënien e tatimpaguesit me çdo ambient të deklaruar të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike tregtare. Drejtoritë Rajonale Tatimore do të verifikojnë dhe përlllogaritin tatimin në burim të qirave për të gjithë tatimpaguesit që nuk ushtrojnë veprimtarinë në ambiente në pronësi të tyre dhe janë subjekte të kësaj përgjegjësie tatimore,



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE**

në zbatim dhe sipas parashikimeve të VKM nr. 469, datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”.

Për të gjitha rastet e konstatuara me mangësi në dokumentacionin e administruar që vërteton marrëdhënien e tatimpaguesit me çdo ambient të deklaruar të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike tregtare, bazuar në nenin 60, të Ligjit nr. 9920, datë 19.08.2008, “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, duhet të merren masat për të kërkuar zyrtarisht prej tatimpaguesve informacion lidhur me marrëdhënien e tij me ambientin e deklaruar dhe plotësimin e dosjes personale me dokumentacionin përkatës provues. Pas përgjigjes së tatimpaguesit, Drejtoria Rajonale Tatimore duhet të vijojë me vlerësimin dhe përlllogaritjen e detyrimeve tatimore të tatimit në burim për qiratë sipas kësaj VKM-je pavarësisht mungesës së dokumentacionit të administruar, apo përfundimit të afatit të vlefshmërisë së kontratave të qirave të administruara. Përlllogaritja e detyrimeve si më sipër, do të bëhet bazuar në çmimet referuese apo kontratën e depozituar për çdo ambient që nuk është në pronësi të tatimpaguesit që ushtron aktivitet ekonomik në të.

Në rastin kur individ i pasurisë së paluajtshme (trualli, ndërtesa apo ambient tjetër), është edhe pronar i shoqërisë tregtare me status juridik sipas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit si dhe në administratën tatimore, marrëdhënia ndërmjet palëve lidhur me ambientin respektiv do të konsiderohet si qiradhënie pavarësisht nëse është dokumentuar ose jo si e tillë. Marrëdhënia duhet të jetë funksionale njësoj si në rastin e një kontrate qiraje ndërmjet palëve, pasi individ i pasurisë së paluajtshme dhe shoqëria kanë personalitet juridik të mëvetëm.

Në rastin kur tatimpaguesi ka deklaruar se ushtron aktivitet në një ambient respektiv mbi bazën e një Kontrate Huapërdorje apo marrëveshje tjetër për të lënë ambientin në përdorim, nga ana e DRT respektive do të përlllogaritet vlera e tatimit në burim për këtë ambient bazuar në dispozitat e sipërcituara, duke përdorur metodat alternative të vlerësimit, të parashikuara në nenet 71 dhe 72 të Ligjit nr. 9920, datë 19.08.2008, “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar.

Në rastin kur personat fizikë ushtrajnë aktivitet fitimprurës (të regjistruar si tatimpagues të biznesit të vogël apo me përgjegjësi tatimore tatim fitimi) në ambientet në pronësi të individit personit fizik, nuk do të jenë objekt vlerësimi si më sipër, pasi personi fizik dhe individ i pasurisë së paluajtshme kanë të njëjtin status. Gjithashtu, nuk do të konsiderohet qiradhënie edhe në rast të ushtrimit të aktivitetit nga personi fizik në ambientin e një personi të lidhur të familjes, me kushtin që ai të jetë pjesëtar në të njëjtën çertifikatë familjare.

Në rastin e Enteve publike, Organizatave Jofitimprurëse, Institucioneve fetare, apo veprimtari të tjera, administruara tatimore për çdo rast duhet kërkojë që të vihen në dispozicion kontratat e qiramarrjes nga secili prej tyre, pavarësisht nga koha e nënshkrimit të tyre. Bazuar në ligjin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 33 pika 1 si dhe udhëzimin në zbatim të tij, përcaktohet se të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën 15 përqind *nga shuma bruto e pagesave* që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë. Në gërmën ë) të kësaj pike **janë pagesat për qiratë**.

Në gërmën a) të pikës 2, të nenit të sipërcituar përcaktohet se, nuk mbahet tatim në burim për pagesat e kryera nga personat rezidentë, *vetëm kur këto pagesa u kryhen personave rezidentë shqiptarë të regjistruar si tatimpagues të tatimit mbi fitimin dhe të tatimit mbi vlerën e shtuar ose kur janë tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël*.

Gjithashtu, sjellim në vëmendjen tuaj se, bazuar në pikën 5.5 “Evidentimi dhe mbajtja e tatimit në burim” të Udhëzimit Nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, përcaktohet se personi rezident i regjistruar për qëllime tatimore, i cili kryen pagesat e parashikuara në nenin 33 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”, deklaron dhe paguan tatimin e mbajtur në burim, në masën 15 përqind të shumave bruto të pagesave, deri në datën 20 të muajit që pason muajin e pagesës.

Përjashtim është rasti i qiradhënies së pasurive të paluajtshme, në të cilat janë vendosur Përfaqësitë Diplomatike (Ambasadat). Në këtë rast, vetë individi qiradhënës duhet të llogaritet, deklarojë dhe paguajë tatimin mbi të ardhurat personale për të ardhurat nga qiraja. Drejtoria Rajonale Tatimore, duhet të kërkojë kopje të kontratave të qirasë tek përfaqësitë diplomatike dhe të verifikojë nëse individët qiradhënës deklarajnë dhe paguajnë tatimin mbi të ardhurat personale për të ardhurat e përfituara.

Theksojmë se, në rastet e qiradhënies duhet të zbatohen dispozitat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.469, datë 03.06.2015 të dalë në zbatim të shkronjës ç) të pikës 1 të nenit 72 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ku citojmë: *Mënyra alternative të vlerësimit nuk kufizohen, por bazohen në: ç) Të dhënat e tërthorta, bazuar në çmimet e tregut të mallrave dhe shërbimeve të ngjashme, të çmimeve të referencave të qirave, të përcaktuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave*. Ky vendim ka për objekt përcaktimin për qëllime tatimore të çmimit referues minimal të qirasë së ndërtesave. Theksojmë se në asnjë rast, bazuar në pikën 2 të kësaj VKM-je, vlera e dhënies me qira të ndërtesës nuk do të jetë më e vogël se vlera minimale e qirasë së përcaktuar në këtë vendim.

*Ndërkohë, për çmimet e qirave që janë mbi çmimet referuese minimale sipas përcaktimeve në VKM-së e sipërcituar, detyrimi tatimor përkatës lind për çmimin real sipas kontratës.*

Përsa më sipër, në rast se ambienti ku tatimpaguesi ushtron aktivitetin ekonomik është me qira, edhe në rast të nënshkrimit të kontratës së qirasë sipas legjislacionit përkatës së fushës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

para hyrjes në fuqi të VKM-së 469, datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”, për efekt të llogaritjeve të detyrimeve tatimore pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, **do të zbatohen çmimet e përcaktuara në VKM-në e sipërcituar, nëse vlera e qirasë së përcaktuar në kontratë është më e ulët se ajo e përcaktuar në VKM-në e sipërcituar.**

Përcaktimet në VKM nr.469, datë 03.06.2015, për qëllime tatimore duhet të zbatohen nga të gjithë tatimpaguesit persona juridikë, fizikë apo individë.

### 3. RASTE SPECIFIKE TË TATIMPAGUESVE TË TRAJTUARA PËR PROBLEMATIKA TË HASURA NË PRAKTIKË

#### 3.1. Nga fusha e ligjit të Tatimit mbi të Ardhurat

##### 3.1.1. *Trajtimi nga pikëpamja fiskale e huapërdorjes për sendet e luajtshme.*

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të shkresës Nr. \_\_\_\_\_ Prot., datë \_\_\_\_\_ me lëndë “Kërkesë për interpretim”, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me Nr. \_\_\_\_\_, Prot., datë \_\_\_\_\_, informojmë si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, bazuar në Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 469, datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”, ka dalë me Sqaruese Nr. 21824 Prot., datë 26.10.2018, me qëllim unifikimin e procedurave lidhur me përlllogaritjen e tatimit për të gjitha ambientet ku ushtrohet aktivitet tregtar bazuar mbi një marrëveshje/kontratë të lidhur rregullisht midis subjektit tatimpagues dhe entitetit posedues të ambientit.

Në rastin kur individi pronar i pasurisë së paluajtshme (trualli, ndërtesa apo ambient tjetër), është edhe pronar i shoqërisë tregtare me status juridik sipas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit si dhe në administratën tatimore, marrëdhënia ndërmjet palëve lidhur me ambientin respektiv do të konsiderohet si qiradhënie pavarësisht nëse është dokumentuar ose jo si e tillë. Marrëdhënia duhet të jetë funksionale njësoj si në rastin e një kontrate qiraje ndërmjet palëve, pasi individi pronar i shoqërisë dhe shoqëria kanë personalitet juridik të ndarë.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Për situatën e trajtuar në shkresën tuaj, nëse, makineritë dhe pajisjet që do të vini në dispozicion të nënkontraktorit tuaj ndodhen në ambiente në pronësi të shoqërisë tuaj, atëherë ky rast do të trajtohet sipas përcaktimeve ligjore të mësipërme.

Nëse këto makineri dhe pajisje dërgohen te nënkontraktorët tuaj dhe përdoren në ambiente në pronësi të tyre dhe ky proces është i përcaktuar në kontratën respektive midis jush, në mbështetje të nenit 901 të Ligjit Nr. nr.7850, datë 29.7.1994 Kodi Civil i RSH-së, i ndryshuar, dhe duke qënë se, kemi të bëjmë me sende të luajtshme me një afat të përcaktuar për përdorimin e tyre sipas një kontrate, kjo kontratë do të konsiderohet si një kontratë huapërdorje, ku njëra palë (huadhënësi) i jep palës tjetër (huamarrësit), pa kundërshtëpërblim, një send të caktuar që ta përdorë përkohësisht dhe kjo palë detyrohet ta kthejë atë send në afatin e caktuar në kontratë.